

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr.1, datë 3.2.1999

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit", si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit,

KOMISIONI I MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

A U T O R I Z O N:

Shoqërinë Anonime "Siguria e madhe" sh.a. me emrin e shkurtuar "SIGMA" me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me nr.Akti 20484, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETARI
Harito Qirko

**LEJE PËR FILLIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË
TË SIGURIMEVE DHE/OSE TË RISIGURIMEVE**

Shoqëria e sigurimit "Siguria e Madhe", sh.a., e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me numër akti 20484, me seli në Tiranë në adresën sheshi "Wilson", lejohet të fillojë kryerjen e operacioneve të sigurimit siç janë listuar më poshtë, duke filluar nga data 15 shkurt 1999.

Policat që do të tregtohen sipas grupeve të sigurimit do të jenë si më poshtë:

Grupi 1 dhe 2. SIGURIMI I AKSIDENTEVE DHE SHËNDETIT

- a. Policë sigurimi për aksidentet personale.
- b. Policë sigurimi shëndeti në udhëtim.

Grupet 3, 7 dhe 10. SIGURIME MOTORRIKE

- a. Policë për sigurimin e vetë mjetit motorrik.
- b. Policë për sigurimin e mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (periudha e sigurimit 6 dhe 12-mujore).

c. Certifikatë ndërkombëtare e sigurimit (Karton Jeshil)

- d. Policë sigurimi për mallrat gjatë transportit.

Grupi 6. ANIJET

- a. Policë për sigurimin e vetë anijes

Grupet 8 dhe 9. SIGURIMI NGA ZJARRI DHE DËMTIME TË TJERA NË PRONË.

- a. Policë për sigurimin nga zjarri.
- b. Policë e sigurimit të parave në udhëtim.
- c. Policë e sigurimit CAR.
- d. Policë për sigurimin nga vjedhja.

Grupi 13. PËRGJEGJËSI CIVILE TË PËRGJITHSHME

- a. Policë për sigurimin e përgjegjësi publike dhe të produktit.

Grupi 15. GARANCITË

- a. Kontrata e garancisë për ndërtimet.

Kjo Leje për ushtrim veprimtarie është pjesë përbërëse dhe i bashkëngjitet Autorizimit Zyrtar nr.1, datë 3.2.1999.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 3.2.1999 nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 15 shkurt 1999.

KRYETARI
Harito Qirko